

**Përgjigje e Ankesës ndaj referatit për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimitdhënësi për lëndët mësimore Fiziologjia e sportit dhe ushtrimeve sportive, Kineziterapi**

Ankesa ndaj referatit për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimitdhënësi për lëndët mësimore Fiziologjia e sportit dhe ushtrimeve sportive, Kineziterapi u shqyrtua me kujdes nga anëtarët e Komisionit recenzues në përbërje: Prof. Dr. Vullnet Ameti – kryetar, Prof. Dr. Ajri Ziba – anëtar dhe Prof. Dr. Isa Asllani – anëtar dhe Komisioni në fjalë e jep këtë Përgjigje në formë të raportit tekstual:

Ankesa e dorëzuar nga kandidati dr. sc. Bajram Kamberi është e pabazë dhe në kundërshtim me nenin 79 dhe 80 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve dhe të asistent-doktorantëve në Universitetin Shtetëror të Tetovës nr. 02-3702/1 e datës 12.06.2014. Kjo për disa arsye:

- Ndaj referatit të Komisionit recenzues, kandidati nuk ka të drejtë Ankesë por ka të drejtë Kundërshtim. Komisioni recenzues nuk sjellë Vendim por jep Propozim, dhe prandaj në pajtim me nenin 79 të Rregullores së cituar më lartë, kandidati do të duhej të dorëzojë Kundërshtim ndaj referatit e jo Ankesë.

Edhe pse Komisioni recenzues konkludon se Ankesa është e pabazë, përsëri e shqyrtoi Ankesën e kandidatit dhe raporton si më poshtë:

- Kandidati dr. sc. Bajram Kamberi pretendon që pikët e shënuara në shtojcën tabelare të referatit për zgjedhje nuk janë të grumbulluara në mënyrë të duhur. Komisioni recenzues konstaton se vlerësimi me pikë dhe grumbullimi i pikëve është në pajtim të plotë me Kriteriumet për vlerësimin e arritjeve të kandidatëve për zgjedhje në thirrje mësimore dhe në pajtim të plotë Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve dhe të asistent-doktorantëve në Universitetin Shtetëror të Tetovës nr. 02-3702/1 e datës 12.06.2014.

- Kandidati i propozuar për zgjedhje në thirrje mësimore shkencore Prof. Dr. Metin Dalip e plotëson numrin e duhur të pikëve për t'u zgjedhur në thirrjen mësimore-shkencore profesor ordinar.

Komisioni recenzues, pas shqyrtimit të dosjes së kandidatit dhe parashtruesit të Ankesës dr. sc. Bajram Kamberi ka konstatuar se i njëjti në konkurs nuk ka dorëzuar Vendim për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore Profesor inordinar dhe Vendim për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore Docent. Poashtu kandidati dr. sc. Bajram Kamberi nuk ka dorëzuar dëshmi për angazhimin e tij në procesin mësimor-shkencor në Fakultetin e Kulturës Fizike.

Nga ana tjetër, kandidati i propozuar Prof. Dr. Metin Dalip ka dorëzuar Vendimin për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore Docent dhe Vendimin për thirrje mësimore-shkencore Profesor inordinar. Kandidati i propozuar Metin Dalip është në marrëdhënie të rregullt të punës në Fakultetin e Kulturës Fizike në Universitetin e Tetovës që nga viti 2007 dhe me sukses e ka kryer veprimtarinë e tij mësimore për lëndët mësimore Fiziologjia e sportit dhe ushtrimeve sportive, Kineziterapi.

#### **PËRFUNDIM ME PROPOZIM**

Nga e gjithë kjo që u tha më lartë, Komisioni recenzues konsideron që Ankesa e kandidatit dr. sc. Bajram Kamberi, nr. 19-176/1 e datës 06.04.2018 është e pabazë.

Komisioni recenzues në përbërje Prof. Dr. Vullnet Ameti – kryetar, Prof. Dr. Ajri Ziba – anëtar dhe Prof. Dr. Isa Asllani – anëtar ka nderin e veçantë që edhe njëherë Këshillit të Rektoratit dhe Senatit t'i propozojë që kandidati Prof. Dr. Metin Dalip të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore profesor ordinar për lëndët mësimore Fiziologjia e sportit dhe ushtrimeve sportive, Kineziterapi.

Tetovë, 10.04.2018

Komisioni recenzues

Prof. Dr. Vullnet Ameti

Prof. Dr. Ajri Ziba

Prof. Dr. Isa Asllani

